

Komisioni i Disiplinës VENDIM Nr. 1

31 janar 2024

Më datë 31 janar 2024 u mbledh Komisioni i Disiplinës i FSHB-së nën drejtimin e kryetarit, z. Klevis Kaso, me praninë e anëtarëve, z. Franko Bushati dhe z. Klaudio Ndoja, për trajtim të çështjeve të mëposhtme:

1. Incidenti i ndodhur në ndeshjen e kampionatit kombëtar meshkuj 2023-24, Besëlidhja - Teuta, java e XII-të, datë 27.01.2024, pallati i sportit "Asllan Rusi", Tiranë. Gjatë ndeshjes në fjalë, gjyqtari ndërkombëtar, z. Edison Gjoni, i ndodhur në pallatin e sportit si spektator, është sulmuar verbalisht dhe fizikisht nga shoqëruesi i ekipit Besëlidhja meshkuj, z. Erion Lleshi. Ky incident është objekt trajtimi i Komisionit të Disiplinës duke pasur në konsideratë se konfrontimi i z. Lleshi, i cili është njëkohësisht dhe Sekretar i Përgjithshëm i shoqatës "Eagles Basket", lidhet me veprimtarinë dhe detyrën e z. Gjoni si gjyqtarë në kampionatin kombëtar të basketbollit meshkuj të rritur;
2. Mospjesëmarrja në ceremoninë e dhënies së Kupës së Shqipërisë Femra 2024 nga ekipi i Partizanit, në përfundim të ndeshjes finale Flamurtari – Partizani, datë 18.01.2024, pallati i sportit "Flamurtari", Vlorë.

Për çështjet e mësipërme, Komisioni i Disiplinës pasi trajtoi materialet përkatëse për shqyrtim, Vendosi:

1. Përgjithshëm 6 muaj nga të gjitha aktivitetet e FSHB-së për z. Erion Lleshi – Sekretar i Përgjithshëm i shoqatës "Eagles Basket", bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 14.12: *"Sulmi fizik ndaj kundërshtarëve (lojtar, trajner, etj), spektatorëve, pjesëtarëve të ekipit të tij, zyrtarëve të ndeshjes (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj), apo pjesëmarrës të tjerë në ndeshje, para, gjatë ose pas ndeshjes."*;
2. Sanksion financiar në vlerën 100'000 lek për ekipin Partizani femra të rritura, bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 12.7: *"Në rast se në përfundim të një ndeshje, do të zhvillohet ceremoni për shpalljen e fituesit të aktivitetit, ekipet janë të detyruara të marrin pjesë në të. Mosrespektimi i këtij rregulli (pjesëmarrja në ceremoni) gjobitet me 100'000 lekë."*

Në bazë të rregullores së aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 11.8, kundër vendimeve të mësipërme mund të apelohe brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.



Klevis Kaso
Kryetar



Franko Bushati
Anëtar



Klaudio Ndoja
Anëtar